



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Protalo Received/Delivety	24. 02 3	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHIK	2120/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1317/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1317/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit ne çeshtjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.1317/2022 e datës 30.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër RN00009119 i datës 30.11.2022 i nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit lidhur me refuzimin e ankesës se ankuesit.

III. Mbetet në fuqi Njoftimi Nr.RN00009119/04 i datës 18.11.2022 si dhe Njoftimi Nr.RN0000/05 i datës 06.12.2022, të nxjerra nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 26.05.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 10.06.2022 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00009119 për lëvizje brenda

kategorisë lidhur me pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme" në Drejtorinë e Administratës për klasën e pozitës Drejtues i ulët 2.

Ankuesi me datën 17.06.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në njoftimin me numër Nr.RN00009119/04 të datës 18.11.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, i njëjti është njoftuar lidhur me pikët e arritura me gjithsejtë 25 pikë, e që mbi këtë bazë procedura lidhur me pozitën për "Udhëheqës të Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme" në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Prizrenit ka përfunduar pa kandidatë fitues.

I pa kënaqur me njoftimin me numër RN00009119/05 të datës 08.11.2022 lidhur me vlerësimin e intervistës me gojë nga ana e komisionit vlerësues, me datën 18.11.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit si dhe Komisioni i vlerësimit me pretendimet ankimore se i njëjti nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit, ky proces ka pasur tejzgjatje të afateve pasiqë nuk ka pasur kandidatë të interesuar për këtë pozitë si dhe se i njëjti poashtu pretendon se konkurset tjera që janë zhvilluar pas këtij konkursi kanë përfunduar brenda afateve ligjore.

Me datën 30.11.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Prizrenit, ka nxjerrë Vendimin RN00009119 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e komisionit vlerësues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.12.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 8648/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se sipas tij nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit dhe i njëjti kërkon që Këshilli ta anuloj rezultatin e përfundimit të vlerësimit të datës 18.11.2022, Njoftimin e datës 06.12.2022 si dhe Vendimin e datës 30.11.2022 lidhur me refuzimin e ankesës së tij dhe po ashtu kërkon që të përsëritet intervista e tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.01.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datën 03.02.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 08.02.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:8648/2022 të datës 30.12.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin Nr.RN00009119/05 të datës 06.12.2022 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Ankesën e ankuesit të datës 23.11.2022 e parashtruar tek Komisioni i vlerësimit dhe Zyra e personelit të Komunës së Prizrenit; Vendimin e datës 30.11.2022 nga Kryesuesi i komisionit dhe menaxheri i NJBNJ-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 288/2023 të datës 13.01.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1312/2023 të datës 03.02.2023 nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër të referencës RN00009119 të datës 26.05.2022; Vendimin me numër Nr.RN00009119/01 të datës 26.10.2022 lidhur me formimin e komisionit të pranimit; Akt emërimit të datës 11.09.2019 për Aktvendimin e datës 11.09.2020 për Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 20.06.2016 për Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 20.06.2016 për Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Rezultatet e vlerësimit të gjeneruara tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankuesit të datës 17.06.2022; Diplomën e ankuesit me numër Nr.76 të datës 15.12.2015 nga Universiteti "Ukshin Hoti" Fakulteti Juridik në Prizren; Certifikatën e datës 24-25 shtator të vitit 2018 nga IKAP të ankuesit; Certifikatën e datës 13-14 mars të vitit 2018 nga IKAP të ankuesit; Certifikatën e ankuesit të datës 30-31 maj të vitit 2019 nga Ministria e Financave; Certifikatën e muajit tetor të vitit 2020 të ankuesit nga Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit me numër 02 Nr.111/01-5566/22 të datës 01.06.2022 për ankuesin; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularin e vlerësimit për ankuesin të datës 30.12.2021; Formularin e vlerësimit për ankuesin të datës 26.01.2021; Vërtetimin me numër Nr.03.116-7022/01 të datës 13.04.2022; Diplomën me numër Nr.372 të datës 10.12.2002 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik për Letër rekomandimi nga VNG international; Akt emërimit të datës 29.12.2011 për Kopjen e letërnjoftimit për kandidatin Formularin e vlerësimit për kandidatin të vitit 2021; Formularin e vlerësimit për kandidatin të vitit 2020; Vërtetimin e datës 16.06.2022 për kandidatin nga NJBNJ; E-mailin zyrtar të datës 20.02.2023 lidhur me kërkesën për prova shtesë nga KPMSHCK; Njoftimin e datës 21.06.2022 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve aplikues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën „Udhëheqes i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme“, në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Prizrenit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009119, për klasën e pozitës Drejtues i Ulët 2, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të pakten 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Fakulteti Juridik*
- *Kualifikime të posaçme:*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave, ka konstatuar se për pozitën e lartcekur kanë aplikuar dy (2) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë të dy kandidatët nga lista e aplikimit ku në mesin e tyre është edhe ankuesi. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të

jetëshkrimit, ankuesi nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 25 pikë, ndërsa me datën 18.11.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizreni, ka shpallur Njoftimin me numër Nr.RN00009119/04 sipas të cilit ankuesi ka fituar 25 pikë dhe me këtë rast kjo procedurë e rekrutimit ka përfunduar pa kandidat fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me çështjen në fjalë i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat e rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: " 1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji. 3. Fillimi i procedurës së konkurrimit shpallet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e caktuar për paraqitjen e aplikimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. 4. Procedura e përzgjedhjes është një procedurë konkurruese dhe organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit ku është pozita e lirë. 5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për shqyrtimin e kësaj çështjeje i'u referua edhe dispozitave të Rregullores QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 44 me të cilin është përcaktuar se:" 1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje. 3.Dispozitat, për procedurën e pranimin në shërbimin civil, të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për procedurën e konkurrimit për lëvizjen brenda kategorisë, për aq sa nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të kësaj rregullore", nenin 47 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë, nenin 48 me të cilin përcaktohet se: "1.Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit" si dhe nenin 49 me të cilin përcaktohet se:" 1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues

dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.

Kolegji, lidhur me çështjen në fjalë ka shqyrtuar vlerësimin e ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të kësaj procedure deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill, si dhe në këtë kuptim ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të cilat lidhen me kundërshtimin e vlerësimit në mënyrë të padrejtë nga ana e komisionit të vlerësimit të Komunës së Prizrenit si dhe tej zgjatjen e procedurave të rekrutimit lidhur me pozitën në fjalë. I njëjti fillimisht ka analizuar Vendimin me numër Nr.RN00009119 të datës 30.11.2022 i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në rastin konkret Menaxheri i NJBNJ-së si kryesues i komisionit të vlerësimit, ka konstatuar se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “2. Ankesa shqyrtohet nga KVLBK dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”, ngase vendimi në fjalë është nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të kësaj komune bazuar në nenin 45 paragrafin 6 të rregullores në fjalë e cila rregullon çështjen e ankimit në fazën e verifikimit paraprak e jo edhe të ankimit në fund të vlerësimit të procedurës, po ashtu Kolegji i Këshillit vlerëson se ky vendim është nxjerrë nga ana e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit pa pasur kompetencë për vendosjen e kësaj çështjeje, ngase sipas dispozitës së lartcekur kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit lidhur me vlerësimin përfundimtar të procedurës së rekrutimit në fjalë, ka qenë Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë (KVLB) e jo Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të kësaj komune, kështu që për rastin konkret Kolegji vlerëson vendimi në fjalë është i kundërligjshëm si i tillë ngase është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në këtë drejtim është pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me anulimin e vendit në fjalë është i bazuar dhe ligjor.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka deklaruar se ka pasur zvarritje të kësaj procedure qëllimisht nga ana e kësaj komune, përderisa procedurat e konkurrimit për dy konkurset tjera janë zhvilluar normalisht dhe me këtë rast ka vlerësuar se procedura e rekrutimit për pozitën „Udheheqes i Sektorit për Punë Juridike dhe të Përgjithshme”, në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Prizrenit bazuar në provat e lëndës ka filluar sipas konkursit i cili është publikuar me datën 26.05.2022 ndërsa ka përfunduar sipas Njoftimit me numër Nr.Rn00009119/05 të datës 06.12.2022, njoftim ky i nxjerrë nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit lidhur me shpalljen e rezultateve të vlerësimit dhe njoftimin se procedura në fjalë ka përfunduar pa kandidat fitues. Lidhur me këtë pretendim Kolegji vlerëson se është i bazuar dhe i qëndrueshëm, ngase procedura e rekrutimit për pozitën në fjalë nuk është zhvilluar brenda afateve ligjore siç parashihet me dispozitat e nenit 98 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se: “2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1317/2022, datë 24/02/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.